



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 4124 Prot.

Tiranë, më 26.11 .2021

VENDIM

Nr. 37, datë 25.11.2021

“Për dhënien e titullit “Profesor Emeritus”, Prof. Ismet Elezi”

Bazuar në nenin 38 dhe 61 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 31, germa th), të Statutit të UT-së; në kreun V, pika 2 të VKM-së nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, si dhe pas dhënies së pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 3980/1 prot., datë 28.09.2021, mbi propozimin e bërë nga Fakulteti i Drejtësisë me shkresën nr. 423 prot., datë 01.06.2021, në mbledhjen e datës 25.11.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Të pranojë propozimin e Fakultetit të Drejtësisë dhe të japë në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, titullin “Profesor emeritus”, për Prof. Ismet Elezi me motivacionin:
“Për merita të veçanta në zhvillimin dhe pasurimin e mendimit juridik në Shqipëri, për kontributin e vyer në fushën e së drejtës penale, për merita të shquara profesionale, njerëzore e qytetare.”
2. Ngarkohet Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët në Rektoratin e UT-së, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Dr. Artan Hoxha

